

Shënim hyrës

Behet fjalë për dy gazeta “Java” dhe “Dita Jug”, të cilat qarkulluan në Gjirokastër, me ndërpreje për gati 15 vjet. Gazeta “Java”, ishte në fakt një investim i Greqisë nëpërmjet konsullatës greke në Gjirokastër. Unë u thirra atje të punoja si gazetar, pasi, që kur u pushova nga emisioni në gjuhën greke në Radio Gjirokastra, ende nuk kisha një punë të dhenë. Por dhash dorëheqjen. Drejtori i Gazetës më kërkonte në punë nga ora 7 deri në orën 15 ndryshe do të më priste rrogën, ashtu se edhe bëri. Kështu që unë u largova. Më vonë mora vesh se emri im përbënte garancinë e financimit grek, pasi unë duhet të mbaja peshën e interesave të palës greke dhe të minoritetit grek në gazetë. Konsulli nuk kishte treguar për largimin tim nga gazeta në Athinë... Kur e morën vesh u konsiderua një skandal, por u mbyll shpejt. Një nga lojrat e njohura në kurrizin tim.

Nëjse, nga botimet në këto dy gazeta u ruajtën në arkivin tim 11 artikuj nga të cilat 6 i takojnë gazetës Java, shkurt-gusht 1995 dhe pesë gazetës Dita Jug, shtator 2002 qershor 2004, gjithsej 20 faqe.

Pavarësisht se bëhet fjalë për shtyp lokal, në shkrimet e mia ruhet një nivel analitik i lartë dhe është i pranishëm kuadri i përgjithshëm politikë dhe i problematikës në vend. Kuptohet që përparësi kishin problemet e Minoriteti etnik Grek dhe marrëdhëniet midis dy vendeve.

Εισαγωγή

Πρόκειται στην ουσία για δύο εφημερίδες “Java” και “Dita Jug”, οι οποίες κυκλοφόρησαν στο Αργυρόκαστρο με διακοπές, για περίπου 15 χρόνια. Η εφημερίδα “Java” κυκλοφόρησε με χορηγό την Ελλάδα μέσω του Γενικού Προξενείου της στο Αργυρόκαστρο. Με κάλεσαν έμμισθο διότι από τότε που εκδιώχτηκα από την ελληνική εκπομπή στο Ραδιοφωνικό Σταθμό Αργυροκάστρου, (Οκτώβρη 1993), δεν είχα μια μόνιμη θέση εργασίας. Αλλά γρήγορα υπέβαλα παραίτηση. Ο διευθυντής της εφημερίδας απαιτούσε να βρισκόμουν στο γραφείο από τις 7 η ώρα το πρωί μέχρι η ώρα 15, διαφορετικά θα μου έκοβε το μισθό, όπως και το έκανε. Και εγώ υπέβαλα παραίτηση. Αργότερα έμαθα ότι το όνομά μου αποτελούσε την εγγύηση για την ελληνική χορήγηση, εφόσον υπολογίζονταν ότι εγώ θα έφερνα το βάρος των ελληνικών συμφερόντων στην εφημερίδα. Ο Έλληνας Πρόξενος δεν ενημέρωσε στην Αθήνα για τη δική μου παραίτηση.. Όταν η Αθήνα το πληροφορήθηκε έγινε θόρυβος και θεωρήθηκε σκάνδαλο, αλλά έκλεισε γρήγορα. Ένα από τα πολλά παιχνίδια που παίχτηκαν στη ράχη μου....

Από τα δημοσιεύματα στις δύο αυτές εφημερίδες διατηρούνται στο αρχείο μου 11 άρθρα, από τα οποία 6 στην εφημερίδα “Java” και ανήκουν στην περίοδο Φλεβάρη-Αύγουστο 1995 και 5 στην εφημερίδα “Dita Jug”, Σεπτέμβρη 2002-Ιούνη 2004, συνολικά 20 σελίδες

Ανεξαρτήτως ότι πρόκειται για τοπικές εφημερίδες, τα γραπτά μου διατηρούν υψηλό αναλυτικό επίπεδο. Ο προβληματισμός εντάσσεται στο γενικότερο πολιτικό, κοινωνικό και οικονομικό πλαίσιο στη χώρα. Εννοείται ότι προτεραιότητα είχαν τα θέματα που αφορούν την Εθνική Ελληνική Μειονότητα και τις ελληνοαλβανικές σχέσεις

PËRMBAJTJA

- 1. Shqetësimi i Barba Jorgos**
05.09.2002. faq. 3.

- 2. Drejtori i Pergjithshem i UNESKOS, Koichiro Matsuura në Gjirokastrë**
21.09.2001 faq. 5.

- 3. Nënvoja imedjate për ndryshimin e qëndrimeve ndaj historisë dhe realitetit të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri**
21.02.2004 faq. 7.

- 4. Përse ky manaxhim diletentesh i vizitës së trupit diplomatik të huaj në Gjirokastrë?!!**
Fillim qërshori 2004 faq. 11.

- 5. Pse kjo tendencë diskriminuese i policisë elektrike ndaj konsumatorëve të rregullt në krahinat e minoritetit etnik Grek?!!**
26.06.2004 faq. 13.

- 6. Papulias nxiton drejt Tiranës (Gazeta JAVA)**
18.02.1995 faq. 15

- 7. Për marrëdhëniet shqiptaro-greke nuk mjafton vetëm klima pozitive (Gazeta JAVA)**
23.05.1995 faq. 16.

- 8. Nano më pranë Berishës (Gazeta JAVA)**
13.07.1995 faq. 17.

- 9. PD-ja do t'i jap natyrë tjetër hartës politike (Gazeta JAVA)**
16.07.1995 faq. 18.

- 10. Tranzicioni dhe vlerat ne udhëkryq (Gazeta JAVA)**
30.07.1995 faq. 19.

- 11. Tranzicioni dhe feja (Gazeta JAVA)**
17.08.1995 faq. 20

Nga Panajot Barka

Shqetësimi i Barba Jorgos

05.09.2002.

Para një viti e ca degjova në anën tjetër të telefonit zerin e barba Jorgos. Në fillim ndjeva faj që nuk e kisha marrë prej kohesh në telefon. Por në vijim me befasoi qëllimi i telefonatës së tij. Barba Jorgua ishte shqetësuar shumë se i nipi kishte marrë me vete deri në shtëpi erën e rendë të klasës ku mësonte dhe të autobusit që i transportonte. Për të ishte e papranueshme ajo gjendje dhe veçanarisht transportimi me një mjet të papërshtatshëm ku “fëmijët shtypëshin si sardele”.

Pse po çuditesha.

Në ndërgjegjën time barba Jorgua kishte zenë vendin e njeriut që i ngjan një sahati me ndërgjegje. Përpikmeria në orar, fisnakeria në sjellje për të mos ofenduar askend edhe kur ia bënin borxh, respekti që të impononte pastertia dhe hiheshia e veshjës dhe mënyra e zgjedhur për t'i venë në dukje gabimin tjetrit, respektimi i parimit për të thenë mendimin e vet pa ia imponuar atë askujt, ndërgjegjja profesionale me të cilën kryente një punë pa iu referuar parimëve ideologjike apo politike aq të domosdoshme për të mbijetuar në atë kohë, ishte kompleksi i karakteristikave të tij që kishin imponuar tek mua krahasimin me sahatin me ndërgjegje.

E pra ky njëri që në pamje të përgjithshme dukej indiferent, ky njëri që tani vertetë i imponuar nga mosha ishte i shkëputur plotësisht nga shoqëria, kërkonte ndihmë për të protestuar, se një grupi femijësh nuk u krijoheshin kushte të përshtatshme për t'u edukuar ashtu siç duhet.

Unë besoj se kisha fatin e mirë që në momentet kritike për të hyrë në një kategori tjetër shoqërore dhe intelektuale me rendësi për kohën, që kaloja nga një mësues fshati dhe një familje po fshati por e lidhur ama vetëm me arën, në gazetar radioje, të kisha atë si mësues.

Barba Jorgua nuk mërzoj asnjëherë për gabimet e shumta që bëja fillimisht në mikrofon. Ai e kuptonte që unë kërkoja të imitoja në spikërim jo atë por të famshmën Evi Demiri të televizionit publik grek dhe kurrë nuk tregoi shenjën më të vogël bezdiseje.

Përkundrazi me mënyrat e tij stimulonte çdo lloj përparimi tonin dhe kur e kuptoi se ishte i zëvendësueshëm, për çudinë e të gjithëve u largua me takt vet duke qenë vazhdimisht mik i emisionit greqisht në radio Gjirokastra dhe i gatshëm për të ndihmuar për çdo gjë dhe kurdoherë

Shtatë vjet janë shumë të kesh pranë një barba Jorgo. Mjafton që të ishe i gatshëm të mesoje prej tij. Ai dinte vendin e shakase, të ndërhyrjes, të hapjës së bisedës. Ai kuptonte kur prania e tij ishte apo jo e dëshirueshme dhe vendoste reciprokisht. Mënyra si ai dhe koloset e tjerë të përdorimit të gjuhës greke përballonin orët e panumërta të përkthimëve të fjalimëve të gjata që kërkonin një përgjegjesi të barasvlefshme me fatin e jetës, vullneti për të thenë gjithçka sakt dhe për të respektuar dëgjuesin, mënyra si ai zgjidhte me kolegët çdo mosmarrëveshje profesionale, (ai kurrë dhe me askend së kishte mosmarrëveshje të tjera) është pak për të thenë se përbën shkollë

Barba Jorgua ishte shumë këmbëngulës në aftesimin dhe në përdorimin e drejtë të gjuhës greke, por kurrë nuk e lidhte punën e tij profesionale me politikën dhe ideologjinë që ajo përçonte. Ndryshe nga kolegë të tjerë të tij që përgatisnin atëherë emisionin greqisht pranonte me kënaqësi çdo element të ri që i shtohej këtij emisioni.

Ai pranonte që t'i rrije pranë edhe duke qenë i djersirë, por kurrë nuk ia lëjonte vetës që të mos vishej pastër e bukur, të mos ishte korrekt në orar, apo të harronte diçka nga ato që duheshin bërë në kohën dhe në vendin e duhur.

Kuptohet, çdo njëri orientohet në jetën e tij nga disa pika apo sisteme referimi të mishëruar në karakteret dhe në portretet e një apo disa njërëzve. Për mua Jorgo Rafti ishte një i tillë dhe do të isha i lumtur t'i arrija ato, sidomos sot në kohën tonë ku ankthi dhe stresi po kthehen në sindromin negativë të jetës në shoqëri.

Nga Panajot Barka

për Dita Jug 05.09.2002.

Nga Panajot Barka

Drejtori i Pergjithshem i UNESCO, Koichiro Matsuura në Gjirokastrë

21.09.2001

Diten e merkure, me 19.09.2001, qytetin e Gjirokastrës e vizitoi Drejtori i Pergjithshem i UNESCO, Koichiro Matsuura

Vizita, duke u nisur nga autoriteti perben nje evenimen historik per qytetin. Rendesia shtohet po te kemi parasysh sa dhe si u lakua emri e ketij institucioni nderkombetar gjate gjithe ketyre viteve si shprese vendimtare per fatin e kultures materiale te qytetit muze te Gjirokastrës. Vizita e Koichiro Matsuuras shenonte ne kete kuader nje moment vendimtar. Por cfare ndodhi. Faktet treguan se vizita nuk ishte manaxhuar dhe Gjirokastritet lane nje rast te ralle tu iki nga dora

Drejtori i Pergjithsem i Uneskos Japonezi Koichiro Matsuura erdhi ne Gjirokastrë dhe tregoi se para se te vinte e kishte hapur dhe studiuar dosjen me kerkesen e qeverise shqiptare dhe autoriteteve lokale drejtuar UNESCO, qe kalaja e Gjirokastrës per vlerat e saj te mirrej nen mbrojtjen dhe kujdestarine e saj .

Po nga ana jone.

Se pari treguam qe po ate dosje ose nuk e njohim mire, ose nuk e kemi pervesuar qe te mund te perpiqemi per te arritur objektivin. Pyetjet e Japonezitet te kultures nderkombetare per kalane dhe mjedisin e qytetit tregojne se ne nuk kemi arritur akoma te evidentojme tek kalaja ata elemente qe realisht perbejne vlera kulturore nderkombetare. Kur e viziton kalane me nje njeri te tille qe mbi te gjitha ka ne dore nje rubinet ekonomik me peshe nderkombetare, ndjen me shume se ai se si kalaja eshte lene ne mashire te veprimit te agjenteve atmosferike, te papastertise dhe harreses. Kete lloj karshillek e ndjen ne fyt kur vizitori i ralle dhe i rendesishem kerkon te mesoj se cili eshte kontributi yne per te mirembajtur kete monoment kulturor.

Ne, dosjen e derguar Uneskos ne themi se kalaja dhe Gjirokastra jane produkte te faktoreve dhe marredhenjeve ekonomiko-shoqerore te nje historie teper te gjate dhe te nje rajoni shume me te gjere se Gjirokastra, duke pasqyruar si ne aspektin diakronik edhe shoqeror, gershetimin e kulturave te ndryshme. Dhe mbi kete baze me te drejte kerkohet qe keto vlera t'u bashkngjiten vlerave boterore. "Vuara re , tha Koichiro Matsuura se ketu kemi te bejme me nje gershteim kulturash. »

Por sa pune behet per te evidentuar pikerishte kete , duke filluar qe nga hulumtime te reja mbi historine, rolin, funksionimin e kalase ne periudha te ndryshme, arkitekturen, menyren e ndertimit, per te cilat mund te shkruhen libra te tere (Dhe ne i themi cdo vizitori pavaresisht nga pesha deh nevoja per te nje variant legjende per emrin) si dhe per manxhimin figurativ te kalase ? (!) (Ishte tmeresisht e tmershme kur njerezit qe e shoqeronin Drejtorin e UNESCO kerkonin ndonje dokument filmik apo figurativ per t'ja dhene si element bindes per nje vendim pozitiv dhe nuk kishte askush)

Nga ana tjeter mbi kalane e lashte ne vazhdojme akoma te mbajme elemente ideologjike nga lufta e dyte boterore, elemente te luftes se ftohte, apo shtojme mbi trupin e kalase elemente te tjere , te cilat edhe pse shenojne nje vlere, apo karakteristike te gjirokastritet nuk e kane vendin etje.

Se dyti Kalaja qendron si monument kulture ne kuadrin e pergjithsem te ansambllit arkitekturor te Gjirokastrës. Pra dhe UNESCO nuk mund te interesohet vetem per kalane kur qyteti i mrekullueshem te pershendet me ngerdheshjet e shkaterrimeve nga njera ane dhe nen sulmin e arkitektures se betonit pa plan , pa pershtatje dhe pa leje nga ana tjeter. Keshtu ne i treguam njeriut te UNESCO se nuk jemi brezi qe jemi ne veshtiresi , dhe per kete kerkojme ndihme, per te transmetuar vlerat e trasheguara

brezave te tjere, por jemi brezi qe i vume ne dyshim keto vlera dhe eshte veshtire te bindim kend ne bote se jemi te afte t' i administrojme ato. Edhe sikur te na e ribejne Gjirokastren sipas pretendimeve tona, apo standarteve te tyre eshte veshtire ta na e besojne per ta administruar.

Se treti Koichiro Matsuura , erdhi ne Gjirokaster i shoqeruar nga nje grup bashkpunetoresh. Atij iu bashkengjiten perfaqesues te fondacioneve te ndryshme te huaj qe veprojne ne kete fushe ne jug te vendit. Kudo i palodhur Artan Skreli, deri tek lindja e pyetjes, « mos eshte gjirokastrit ky ? » Po nga ana jone. I vetmi kryetari i bashkise dhe ciceronja . Ku ishin njerezit qe paguhen per ceshtjet e kultures (qe per te vertetuar se interesohen per kulturen pergatisin dieta per 33 dite ne muaj), ku ishin njerezit e tjere te artit, apo dhe njerez te tjere per te manifestuar pikerisht respektin per Koichiro Matsuura dhe UNESKON, por dhe interesimin per renimin e Gjirokastres. Ku ishte ai prezantim I vlerave te tjera te kultures materiale e tradicionale te Gjirokastres qe t'I krijonin imazhin Koichiro Matsuuras se dime t'I administrojme vlerat pa ze te arkitektures se gurit.

Me siguri qe Japonezi, u habit kur kete vlere nderkombetare pa ta ruanin disa police zberthyer dhe te parruar qe ngjanin sikur qe nga 11 shtatori kishin humbur labirinteve te kalase per te gjetur terroristet e Bin Ladenit.

Dhe patjeter qe ai u befasua kur ne kafenen e kalase, ne vend te gjerave me karakteristike popullore qe ka Gjirokastra , njeriut te kultures se trasheguar boterore iu serviren pije freskuese me kanace (Dhe po te paguheshin nuk do te ishin me provokativ se aq) (!!)

Koichiro Matsuura kur foli la te kuptohet se e para arkitekture qe duhet restauruar dhe kujdesur eshte ajo e koshiences tone per keto vlera dhe kontributit tone per to. Megjithate kur pa fytyrat e te pranishmeve qe u bene me te hirta se guret e kalase tha “nje dite mund ta shohim Gjirokastren ne listen e objekteve nen kujdestarine e UNESKOS” dhe u kenaq kur pa se vetem me kaq arriti t'u kthente te pranishmeve buseqeshjen.

P BARKA Δημοσιεύτηκε στο επόμενο φύλλο της εφημερίδας “Dita Jug”

Nëvoja imedjate për ndryshimin e qëndrimeve ndaj historisë dhe realitetit të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri

21.02.2004



Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri përbën një realitet marrëdhëniesh në disa nivele nga të cilat mund të veçonim:

- Marrëdhënjet njerëzore midis njërëzve të thjeshtë, të shumicës dhe pakicës. Marrëdhënjet e minoritetit grek me strukturat e shtetit shqiptar. Minoriteti në raport me marrëdhënjet Shqipëri – Greqi. Marrëdhënjet e shtetit shqiptar me institucionet ndërkombëtare në raport me respektimin e të drejtave të

këtij minoriteti, etj. Të gjitha këto nivele njohin një zhvillim historik brenda të cilit roli, evidentimi dhe përparësitë i çdonjërit ka ulje ngritjet e tij të përcaktuara nga faktorët e ndryshëm.

Mëgjithatë dallon për një konstante në përmirësimin e nivelit të parë, ai i marrëdhëniesh midis përfaqësuesve të thjeshtë shqiptarë e grekë, i cili edhe në rastet që karakterizohen sipas parimit “Duhemi në të njëjtën lartësi urrejtjeje”, tregon se ka krijuar një mekanizëm rregullues të brendshëm shumëshekullor dhe që përcaktohet nga një nënshtrat i përbashkët kulturor e fetar pavarësisht nga diferencimet e mëvonshme të karakterit gjuhësor, fetar apo etnik. Nuk do të ndalem në këtë nivel marrëdhëniesh i cili në shumë drejtime, besoj se të gjithë do të dëshironim të përbënte sistemin e referimit për të gjitha llojet e neveleve të marrëdhëniesh të tjera të përmendura më lart.

Lë të qëndrojmë shkurtimisht në këto nivele të tjera. Marrim në fillim **marrëdhënjet e shtetit shqiptar me institucionet ndërkombëtare në raport me respektimin e të drejtave të minoritetit etnik grek në Shqipëri**

Kam frikë se ende nuk jemi ndërgjegjësuar realisht se po nuk u respektohen të drejtat e njëriut dhe të drejtat e pakicave në veçanti, Shqipëria nuk integrohet në familjen e B.E. Mëgjithatë ajo që vihet re është se kur na hiqet veshi nga ndonjë institucion ndërkombëtar për mos realizimin e kësaj apo asaj “detyre shtëpie” të vënë prej tyre në drejtim të respektimit të të drejtave të njëriut në përgjithësi, ose reagojmë pozitivisht (kryesisht për të venë me shpatulla prej muri qeverinë), ose heshtim. Ndërsa ndaj çdo vërrejtjeje që vjen nga Greqia në adresë të respektimit të drejtave etnike të minoritetit grek, ndodh e kundërta. Krijohet një aleancë e pothuaj të të gjitha strukturave “që kanë zë” për të vërtetuar të kundërtën. (Në një kohë që të mohosh faktin se egzistojnë probleme, është njësoj si këmbëngulja për të mohuar se bëhen përparime) Problemi bëhet me i mbrehtë kur ky një vërrejtje e tillë vjen nga Greqia, (qoftë edhe nga pozicioni i vendit anëtarë i Bashkimit Evropian). Atëherë del në shesh gjithë arsenalin e problematikës historike në marrëdhëniet midis dy shtetëve. Bile, nga mënyra e reagimit krijohet shija e keqe sikur gjithë parametrat e tjerë që garantojnë integrimin e Shqipërisë në BE janë të realizuara, përfshirë sidomos respektimin e të drejtave të minoritetit etnik

grek dhe se janë “pretendimet” e këtij minoriteti dhe të Greqisë për mos respektimin e tyre që e pengojnë këtë proces integrimi (!!). Jam plotësisht i bindur se e kundërta ndodh. E verteton këtë fakti që në çdo rast përfaqësuesit e këtij minoriteti, pse jo në sinkron me Athinën, kanë ngritur të parët flamurin që Shqipëria të mos pengohet në këtë proces integruar. Ashtu ndodhi më 1991 kur Shqipëria hyri në OSBE, siç bëmë kur Shqipëria hyri në Këshillin e Evropës, apo dhe tani së fundi për nënshkrimin e marrëveshjes për çeljen e negociatave me B.E. Këto kurrë nuk i kemi konsideruar e as do të lejohet që të konsiderohen si veprime dobësie apo inferioriteti. Përkundrazi! Dhe kjo ndodh për faktin se vet minoriteti dhe përfaqësuesit e tij të ndikuar nga Athina janë ndërgjegjësuar se vetëm nën monitorimin dhe kuadrin e institucionëve ndërkombëtare dhe të BE minoriteti grek do të mund të gëzojë të gjitha të drejtat që i takojnë.

Në këtë kendvështrim rendësi të dorës së parë merr niveli i marrëdhënëve të minoritetit grek me strukturat shtetit shqiptar.

Kuptohet që parametrat që përcaktojnë këtë nivel marrëdhëniesh janë të shumta. Por më themeloret besoj se janë:

Strukturat zyrtare të shtetit nuk kanë ndërmarrë akoma asnjë hap për përcaktimin e kuadrit të plotë të statusit të këtij minoriteti apo dhe të minoritetëve të tjera, në aspektin e madhësisë demografike, të historisë, të etnisë, të trashëgimisë kulturore, etj për implementimin mbi këtë bazë të kuadrit ligjor. Ato vazhdojnë të operojnë me të njëjta instrumente të historisë së aferme komuniste. Kjo nuk mund të krijojë bindje se në këtë drejtim mund të shkojmë përpara

Në këtë kendvështrim, strukturat zyrtare dhe jozyrtare kanë si pikë referimi nivelin demagogjik të sistemit komunist të respektimit të drejtave të minoritetit etnik grek në Shqipëri. Madje, kjo frymë gjithmonë e më shumë po ndikon edhe në marrëdhënjet midis njërëzve të thjeshtë ku përfaqësues të shumicës nuk mund të “lejojnë” për përfaqësuesit e pakicës me shumë të drejta nga sa statusi i njohur i periudhës komuniste. Po marrë një shembull fare të thjeshtë. Në Vrisera, qendër e komunës së Dropullit të Sipërm me popullsi homogjene greke egziston një klub i një të ardhuri me kombësi shqiptare i cili i ka venë emrin “Kafe Albania”. Askush nuk e ka ngacmuar atë tabelë të shkruar në shqip dhe me atë përmbajtje. Edhe lokali frekuentohet pa asnjë paragjykim. Tridhjetë metra me tutje është një tabelë me një pjesë të emrave të fshatrave të krahinës të shkruara në dy gjuhë, - shqip dhe greqisht. Ato janë fshirë me bojë të zezë dhe mbi to është shkruar “kufijt tanë janë deri në Prevezë” (!!)

Pra kjo do të thotë se shkrimi në dy gjuhë i emrave të fshatrave në disa komuna me popullsi homogjene greke në përputhje me konventën kuadër, është një element që thyen statuskuon e të drejtave të njohura nga sistemi komunist. E keqja është se reagimi i njohur i përfaqësuesve të shumicës për zhdukjen e tyre, shoqërohet me heshtjen aprovuese të strukturave shtetërore.

Fakti bëhet më shqetësues kur vihet re se ky mentalitet po stimulon, në të gjitha nivelet, kontradiktën midis kuadrit ligjor, që relativisht i përgjigjet standartëve ndërkombëtare dhe implementimit të tyre praktik.

I së njëjtë natyrë dhe origjine është edhe fakti tjetër që për nivelin e respektimit të të drejtave të minoritetit grek zëdhënës, apo mbrojtës të tyre, bëhen individë, shoqata dhe struktura të tjera shtetërore dhe jo shtetërore që nuk kanë asnjë lidhje me minoritetin.

Po ashtu shumë nga këto struktura jo vetëm që marrin përsipër këtë rol, por ashtu siç thamë, marrin si sistem referimi respektimin e të drejtave të minoritetit në kohën e diktaturës komuniste duke injoruar me dashje ose pa dashje, nivelin këtyre të drejtave parashikuar në standartet ndërkombëtare. Këtij realiteti i shtohet nga ana tjetër difekti i historisë së këtij minoriteti, histori e njohur me syzat e diktaturës komuniste.

Sistemi i referimit komunist në respektimin e të drejtave të minoritetit dhe pasojat nga reflektimi i tij në kushtet e sotme

Dihet se nevoja e sistemit komunist për të ruajtur dhe garantuar një unitet të brendshëm që nuk do të vinte në dyshim pushtetin e vet, e detyroi këtë sistem të kultivonte ndjenjën e social-nacionalizmit. Mjet më efikas për arritjen e saj ishte ballafaqimi imagjinar i realitetit të brendshëm (“i fitorëve të pandalshme socialiste”) me politikën e armiqësisë së fqinjëve jugorë e verior ndaj Shqipërisë. Në këtë kuadër minoriteti grek në Shqipëri nga njëra anë duhet të mohonte identitetin e tij grek (për të shmangur identifikimin me një armik të Shqipërisë, siç konsiderohej Greqia) nga ana tjetër duhet të manifestonte idenë se i respektoheshin të gjitha të drejtat (për të provuar se komunizmi është kampion në respektimin e të drejtave etnike dhe minoritetëve). Kështu ai zgjodhi si identitet një monstër hibrite të përcaktuar në termin “minoritet-minoritar”, duke shmangur kështu fjalën “grek” përcaktuese të identitetit të tij etnik, pasi fjala grek ishte lidhur me fjalën armik.

Ky nacionalizëm i periudhës komuniste me peshë të veçantë në minoritetin etnik grek në Shqipëri, ka ndikimet e veta edhe sot me disa dallime. Ai ishte shtetëror dhe si i tillë që i kontrolluar nga shteti. Sot ai vepron nëpërmjet strukturave të pakontrolluara por dhe të paçliruara nga indokrinimi i periudhës komuniste dhe karakterizon vëçanërisht ato struktura që janë gjeografikisht më larg nga realiteti ku jeton pjesa dermuese e minoritetit grek

Këto shkaqe (bashkë me të tjera që do të shtrohen më poshtë) çuan në atë që në minoritet të shfaqen dy tendenca.

Nga njëra anë kemi tendencën e mohimit të realitetit të marrëdhënëve intensive me elementin shqiptar dhe orientimit drejt çdo gjëje që lidhet me Greqinë. Kjo tendencë lidhet edhe me qëndrimin që mbajnë shpesh përfaqësuesit e organizmave të karakterit etnik të minoritetit, të cilët për të siguruar mbijetesën e tyre politike në raport me Greqinë, inspirojnë në ambjentin e minoritetit dhe në drejtim të faktorit grek, një frymë nacionaliste. Ndërsa në drejtim të Tiranës një frymë evropiane, (se kjo frymë u siguron mbijetesën politike në ambjentet e shtetit shqiptar)

Nga ana tjetër kemi tendencën e integritit në realitetin shqiptar. Kjo tendencë shikohet si mjet për sigurimin e jetësës. Por më së shumti vihet re se realizohet duke huazuar modelet e sistemit komunist, pra duke mohuar ato elementë të identitetit etnik që nuk i cenon shkallën e dëshirueshme të integritit në shoqërinë shqiptare.

Të dyja tendencat, megjithatë nënvizojnë faktin se ambjenti shqiptar nuk arrin t'i pranojë anëtarët e minoritetit etnik grek si të tillë, me identitet etnik të evidentuar, por të fshehur. Ose vet minoriteti grek akoma nuk është bindur se ambjenti shqiptar është i gatshëm për t'i pranuar si të tillë.

Minoriteti në raport me marrëdhënjet Shqipëri – Greqi

Së pari Në Greqi egziston një spektër shumë i gjerë qendrimesh i formëzuar në shtrirjen kohore që nga krijimi i këtij minoriteti si të tillë. Kjo hapësirë fillon me grupimin që i mëshon idesë se problemet duhen zgjidhur në bazë të një momenti të caktuar historik (atë të vendosjes së kufijve ndërshtetërorë, të Protokollit të Korfuzit, apo dhe të periudhave historike që pikonin gjak nga fantazmat nacionaliste) dhe mbaron me grupimin që e shikon trajtimin e minoritetit etnik grek në Shqipëri të çliruar nga kontekste historike me ngarkesa negative dhe në kuadrin e integritit të Shqipërisë në Evropën e Bashkuar.

Në Shqipëri përkundrazi. Në të gjithë shtrirjen kohore në fjalë gjithë problematika lidhur me këtë minoritet ka formësuar idenë se trajtimi dhe respektimi i të drejtave të tij ka qenë në mënyrë përfekte, bile më mirë se pjesa tjetër e popullit shqiptar.

Izolimi 50-vjeçar i Shqipërisë dhe pamundësia e njohjes nga afër të realitetëve dhe zhvillimeve që pesonte minoriteti etnik grek këtu, bashkë me realitetin e provuar se komunizmi si sistem është i keq dhe është i tillë në radhë të parë ndaj pakicave kombëtare, siguroi në Greqi një konservim të tezave diakronike për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të këtij minoriteti në Shqipëri dhe një aktivizim esencial të tyre kur u hapën kufinj të. Pësia e tyre në Greqi u rrit në këtë periudhë se nga ana e tij, një pjesë e minoritetit grek momentin e rivendosjes së marrëdhenjëve me shtetin am më shumë e përjetoi si emocion se sa si një vizion të përcaktuar qartë për të ardhmën e tij. Ndërkohë, mohimi i shtetit totalitarist në Shqipëri, edhe nga ana e këtij minoriteti, u shoqërua me shkatërrimin e pothuaj të gjitha vlerave materiale të tij të krijuara në komunizëm. Përpos kësaj dhe i të gjitha vlerave shpirtërore e kulturore të krijuara gjatë shtetit monist. Ky mohim u shoqërua me largimin drejt Greqisë. (ndikoi shumë negativisht për këtë politika shtetërore dhe tendencioze nacionaliste që ndoqi ndaj tij qeveria e Partisë Demokratike). Gjithë kjo situatë çoi shpesh në një ballafaqim të shtrembëruar midis vizionit bashkëkohor evropian dhe kërkesave reale për respektimin e të drejtave të minoritetit etnik

Në Shqipëri pësia e realitetëve të zymta historike, nevoja për të siguruar një unitet ideologjiko-kombëtar mes një ballafaqimi të përhershëm me armiqtë e shovinist që donin të coptonin Shqipërinë, abuzimi sot me këtë nacionalizëm fals të së kaluarës për shkak të mungesës së një vizioni të ri bashkëkohor, apo si mishërim të idesë për rikuperim të historisë, ose si një mjet efikas për të kapërcyer probleme të mbrehta politike e sociale, çon në qëndrime të njëjta edhe ndaj problemëve të minor. etnik grek.

Kështu p.sh shpesh nga ana e Greqisë kërkohet që trajtimi i minoritetit etnik grek të bëhet në kuadrin gjeografik të termit Vorio-Epir (si nocion gjeografik të pjesës veriore të Epirit). Një kërkesë e tillë jo vetëm që shkakton re të zëza patetizmi nacionalist në Shqipëri, por janë të dukshme kundër-masat. Minoriteti etnik grek kufizohet arbitrarisht brenda 99-100 fshatrave dhe lihet jashtë tij ajo masë e madhe të anëtarëve të këtij minoriteti që gjatë sistemit komunist për shkaqe të ndryshme kanë migruar në pjesë të ndryshme të vendit. Ose numrit 300-400 mijë grek në Shqipëri servirur nga qarqe të ndryshme në Greqi, i kundërpërgjigjet pala Shqiptare me numrin 59 mijë të regjistrimit të kohës së Enver Hoxhës dhe harrohet se në kushtet e rritjes pothuaj të barabartë natyrore të popullsisë (si minoritarë grek ashtu dhe shqiptarë), popullsia shqiptare brenda 50 vjetëve u katërfishua ndërsa popullsia në minoritetin etnik grek u rrit vetëm 1.7 herë. Ndërkohë, shmanget kërkesa për regjistrimin e popullsisë ku të shenohet dhe kombësia. Ky konceptim i minoritetit bie ndesh me parimet moderne sipas të cilave respektimi i të drejtave si të njërit ashtu dhe ato etnike kanë karakter individual dhe jo kolektive apo gjeografike

Në këtë kuadër do të ishte gabim të mos përmendëj fakti që midis palëve,- Shqipërisë dhe Greqisë,- (pavarësisht nga pozicioni në spektrin e qëndrimeve në këtë të fundit), apo momentëve dhe realitetëve të marrëdhenjëve shumë të mira, ka qëndrime krejt të kundërta e shpesh të skajshme e të mbrojtura me fanatizëm, lidhur me probleme të tilla siç janë madhësia demografike, historia e origjinës etnike, trashëgimia kulturore, shtrirja gjeografike me pasojë shpesh kërkesa për reciprocitete pa asnjë bazë etj. Moszgjidhja problemëve, si atyre të karakterit historik, (duke kongluduar për një histori të njëhësuar, në vend të dy historive të kundërta që kemi sot lidhur me të njëjtin realitet historik) edhe problemeve që përcaktojnë realitetin e sotëm, mos ridimensionimi i qëndrimeve nga të gjitha palët e interesuara me pjesëmarrjen e faktorit ndërkombëtar, është e sigurt se asnjëherë nuk mund të garantohet implementimi esencial i një kuadri ligjor sado i përparuar qoftë. U botua DITA JUG 21.02.2004

Nga Panajot Barka

Përse ky manaxhim diletentesh i vizitës së trupit diplomatik të huaj në Gjirokastrë?!!

Fillim qërshori 2004

Populli thotë se zogu një herë të vjen në dorë . Kjo do të thotë se fati jo gjithmonë të buzëqesh. Mund të ndodh që rastin e duhur të mos e shfrytëzosh një herë dhe të gjesh një mijë arsye për t'u justifikuar. Por kur të njëjtat situata përsëriten në formën e rastit të humbur, atëherë më të drejtë të dedikohen defekte serioze paaftësie. Fatkeqësia merr vlera shoqërore me përmasa serioze kur rastet e humbura përsëriten nga faktorë që përfaqësojnë, ose kanë marrë përsipër të drejtojnë komunitetin, ose ky komunitet u ka besuar drejtimin e tij.

Kjo po ndodh me pushtetin tonë lokal.

Në shtator 2001, një ditë pas festës së Gjirokastrës, qytetin e vizitoi drejtori i përgjithshëm u UNESCO-s Koichiro Matsuura. Prezantimi amatoresk i pushtetit lokal të atëhershëm në këtë vizitë, prezantimi me mungesa të pariparueshme të faktorëve të infrastrukturës kulturore, deri në detajet elementare të mikpritjes tradicionale, që do të krijonin bindjen tek autoriteti i UNESCO-s për të fituar përkrahjen e këtij institucioni të OKB-së për qytetin e Gjirokastrës, përbëjnë, mendojmë, arsyen fatale për mos përfshirjen e ansamblit kulturor gjirokastrit nën kujdestarinë e UNESCO-s

Rasti iku. Mësime nuk u nxorrën.

Në fillim të qërshorit të sivjetshëm, Gjirokastra do të pushtohej nga trupi diplomatik i akredituar në vendin tonë. Për Ministrinë e Jashtme si inisiatore e këtij udhëtimi, përbënte një Weekend të organizuar për trupin diplomatik dhe një mënyrë efektive për të rritur mirëkuptimin në kanalet e komunikimit të sa me këtë trup.

Për pritësit një rast i rrallë me mundësi të pakufizuara jo thjesht për të promovuar vlerat e Gjirokastrës, rrethinave të saj, apo Jugut në përgjithësi, por për të krijuar mundësi përfitimi disaplanëshe për të ndihmuar rajonin të dalë nga ngërçi i stanjacionit provincial të imponuar nga kapitalizmi i egër që shfaq tranzicioni i stërgjatur në vend.

Çfarë duhej të ndodhte.

Paraprakisht çdo përfaqësi diplomatike mund të kishte një dosje informuese si për atë që është Gjirokastra, ashtu dhe për variantet e ndryshme që mund të zgjidhte secili nga ata gjatë dyditëshit të qëndrimit në Gjirokastrë. Kjo presupozonte alternimin e aktivitetëve të përbashkëta me kohën e lirë aktive individuale ose në grupe.

Në bazë të interesimit në sektor e fusha të ndryshme të shfaqur nga shtete të veçanta ndaj vendit tonë, mund të organizoheshin takime të orientuara të përfaqësive diplomatike, me struktura apo faktorë analogë në rrethin tonë. Këto takime po të ishin të manaxhuara mirë më siguri që do të promovonin lidhje të qënësishme dhe kontribute konkrete për komunitetin tonë në të ardhmen.

Mund të organizoheshin kafe intime, familjare apo dhe individuale të autoritetëve të pushtetit lokal, të faktorëve të tjerë të rendësishme të jetës kulturore, sociale e ekonomike, për të krijuar ato miqësi e lidhje aq të domosdoshme për në komunitet provincial dhe njëkohësisht aq të nevojshme për piknisje të projektëve të ndryshme. Mund të përmendim edhe mundësi të tjera. Ose nëqoftëse autoritetet e pushtetit vendor për përgatitjen dhe manaxhimin e kësaj vizite do të kishin menduar të thërrisnin në ndihmë intelektualë e kuadro të fushave të ndryshme, pra me shumë mendje nga mendimet e tyre të prera në formate detyrimisht të burokratizuara apo të standartizuara,

me siguri që do të ishte një vizitë me vlera historike për Gjirokastrën dhe rajonin e saj.

Tani historizm mbeti thjesht tek lajmi që ambasadorët erdhën në Gjirokastrë dhe nga 130 vetëm 20.

Çfarë ndodhi.

Diplomatët, (e vendëve të huaja), këta njëerëz të cilët kudo dhe kurdoherë dinë të punojnë në mënyrë individualiste dhe për interes të vendit të vet, të cilët e duan kolegun për ta konkuruar në kuadrin e logjikës së ambicjes pozitive, u trajtuan në grup dhe në intenerare kolektive vizitash.

Gjithë interesi i pritësve u konsumua në përgatitjen e drekave e darkave, sikur diplomatet ishin të pangrenë. Ishte në fakt një përpjekje që krijonte përshtypjen se pritësit kishin ndërmend të promovonin vetëm vlerat gastronomike të rajonit, në dem të vlerave të tjera. Por as në këtë drejtim nuk serviren guzhinën tradicionale gjirokastrite por vlerat e antipastave perendimore dhe e mishrave të pjekura.

Madje edhe sponsorizimet e shumifishta, sigurimin e të cilave e kishin marrë përsipër vetë organizatorët, justifikoheshin me këto lloj drekash.

Nga ana tjetër aktivitetet e organizuara, fjalimet e mbajtura etj, të kujtonin skena të stërpara e të stërkonsumuara që të lodhin e të shkaktojnë merzi. Fatkeqësisht shiu dhe koha e keqe e bënë këtë ritual akoma më të zbehtë e më të papërgatitur.

Pse ndodhi kështu.

Arsyet nuk duhen kërkuar tek mosdija. Kush nuk di mëson. Aq më tepër një drejtues është i detyruar të mesojë me shumë kur hipën në karrike se sa kur lufton të hip në të.

Por u duk qartë se organizatorët u përpoqën ta personalizojnë këtë vizitë për kredo personale politike. Përpjekjet egocentrike për tu evidentuar si violinë e parë në disa raste demtuan jo thjesht protokollin zyrtar, por edhe imazhin e mikpritjes tradicionale. Fakt është që ne si opinion publik nuk na u komunikuan as përshtypjet dhe mesazhet e ambasadorëve të huaj, as mesazhet që u transmetuan atyre autoritetet tona. Njëri nga ambasadorët na tha se, jetojmë në pasuri e bukuri të rralla, por që duan kohë dhe përpjekje për t'i shndërruar ato në faktorë turizmi e zhvillimi

Kështu që përfundimisht themi se vizita në Gjirokastrë në fillim të qershorit 2004, e trupit diplomatik të huaj, akredituar në Tiranë, ishte një rast i humbur, i pavenë re dhe i pa komentuar nga opinionioni publik, por që në një seri të gjatë raportimesh e fjalimesh publike të së ardhmës do të përmendet nga autoritetet tona lokale si një sukses i tyre i pashëmbullt. **FUND**

Nga Panajot Barka

Pse kjo tendencë diskriminuese i policisë elektrike ndaj konsumatorëve të rregullt në krahinat e minoritetit etnik Grek?!!

26.06.2004

Ditët e fundit Policia Elektrike e rrethit të Gjirokastrës ndërmori serish një fushatë kontrolli “për të luftuar vjedhjet dhe abuzimet” me korentin në krahinën e Dropullit.

Kuptohet, kjo është një e drejtë e saj funksionale në zbatim të kompetencave që i jep ligji. Po ashtu kuptohet se në rrethana të tilla veprimtaria e saj nuk mund të përbëjë objekt e një shkrimi në gazetë.

Mirëpo në këto fushata “antikorruptive” të policisë elektrike, në krahinat e minoritetit, po vihen re disa fenomene që kompromentojnë funksionin shtetëror të kësaj policie.

Së pari fushatat e policisë elektrike në zonat e minoritetit në Gjirokastrë, krahasimisht me zonat e tjera, janë aq të shpeshta dhe të përqendruara, sa që të jep përshtypjen se gjithë vjedhjet në energjinë elektrike bëhen në këto zona. Ndodh kështu në një kohë që pagesat për energjinë elektrike të konsumuar nga konsumatorët e këtyre krahinave, sidomos në ato fushore, variojnë nga 95-115% dhe janë më të lartat në Republikë. (Mos ju duket fare çudi për faktin se realiteti që në Dropull i paguhet shtetit më shumë energji elektrike nga sa konsumohet, pavarësisht se ndriçohet me orar shpesh më të kufizuar se edhe nga krahinat e tjera në rrethin e Gjirokastrës me pagesa shumë më të ulta).

Pra, në një kohë që shteti nuk ka probleme me pagesat e konsumit të energjisë elektrike në krahinat e minoritetit, pse kjo polici elektrike duhet t’u bie kaq shumë në qafë konsumatorëve të këtyre krahinave. Dhe më keq akoma, pse e bën këtë në mënyrë kaq të diferencuar, në një kohë që konsumatorë të tjerë në rreth kanë në këtë drejtim probleme shumë të mëdha me KESH-in.

Mos vallë në krahinat e minoritetit respektimi i ligjit interpretohet si dobësi e një “militi të butë” dhe për pasojë, kjo polici në emer të ligjit mund t’u fus gjoba për të justifikuar rolin dhe egzistencën e saj, apo kontrollorët e saj të mund t’u bëjnë konsumatorëve këtu presion që të fusin “ndonjë send me vlerë” në xhepin e tyre.

Së dyti. Nuk e përjashtojmë mundësinë që edhe në krahinat e minoritetit mund të ketë abuzime me rrjetin elektrik. (makar që në gjithë Shqipërinë të kishte kaq pak abuzime se nuk do të duhej fare policia elektrike). Por nga shumica e rasteve të gjobitjeve konkludohet shumë lehtë se nuk gjobiten abuzuesit e vertetë dhe me peshë, por konsumatorët e thjeshtë me disa llampa ndriçimi, me një frigorifer, televizor dhe një hekur.

Dhe prap kjo do të ishte e drejtë, po të mos shikoje se gjobat e vëna janë disa herë më të larta se konsumi i mundshëm i energjisë elektrike, si në rastet e Rrezës së Zezë, Pogonit, Sotirës etj.

Por më e keqja është se në shumicën e rasteve këto gjoba vihen kur konsumatorët nuk kanë asnjë faj. Cili është psh, faji i konsumatorit Th. Loli nga Sotira që kishte lajmëruar elektrikun disa herë për sahatin e prishur dhe elektriku nuk kishte marrë masa. Pse A. Kazaqi në Frashtan duhet të paguajë dhe 1 200 KW të cilat figurojnë me dokumente të rregullta se egzistojnë në numërorin e sahatit para se ai ta vinte në përdorim për llogari të tij? Përse iu prenë dritat S. Barutës në Dervician kur dokumentacioni dhe pagesat nga ana e tij janë të rregullta? Përse policia elektrike, pas

presionit të para disa ditëve nga ana e kryetarit të këshillit të fshatit Dervician u detyrua të lëshojë korrentin konsumatorëve që vet e kishte prerë “për shkelje të ndryshme”?

Së treti. Qofsim të gabuar, ose qoftë një koecidencë e keqe, por duke marrë në shqyrtim rast pas rasti dhe momentet e veprimit nga ana e policisë elektrike në krahinat e minoritetit, na rezulton se ajo përpos të tjerave vepron brenda lojës së interesave dhe përplasjeve të grupimeve politike që veprojnë në krahinat e minoritetit në rrethin e Gjirokastrës.

Argumentin e fundit nuk duam ta shtjellojmë më tutje se pavarësisht nga faktet dhe deklaratat e konsumatorëve të demtuar, ne nuk duam të besojmë se një strukturë e shtetërore përdorët nga strukturat partiake në favor të interesave të grupimeve të vogla që përfaqësojnë këto struktura politike.

Nuk duam gjithashtu që kjo situatë, apo dhe veprime të njëjta të përfaqësuesve të ndonë strukture tjetër shtetërore, të interpretohen si argumente në favor të opinionit të përhapur se janë pasoja që rrjedhin nga gjoja përqëndrimi i krahinizar i pushtetit.

Kuptohet , edhe nëse i vertet një diçka e tillë, gjë që siç thamë nuk e besojmë, duke marrë parasysh pasojat e veprimeve të tilla mbi marrëdhëniet dhe ekuilibret në të gjitha rrafshet sociale –ekonomike- kulturore e etnike në rajon , duhen mënjanuar me mjete të tjera dhe jo me mjete publike, siç mund të jetë edhe shtypi.

Panajot Barka Gjirokastër, më 25.06.2004 u botua më 26.06.2004.

Nga Panajot Barka Papulias nxiton drejt Tiranës

18.02.1995

E Shtunë, 18 Shkurt 1995 - Nr. 16 (210) - Çmimi 15 Lekë - 150 Drahmi

Java

E PAVARUR - OPINIONALE - INFORMATIVE

Nga Panajot Barka

PAPULIAS NXITON DREJT TIRANES

Ministri i jashtëm grek K. Papulias konfirmoi të ejeten gjatë një dreke pune me kryeministrin Papandreu se deshiron të vizitojë kryeqytetin e Shqipërisë brenda 15-ditëshit të parë të marsit. Ministri i jashtëm grek, i zhgenjyer vazhdimisht nga mosbesimi i Tiranës ndaj Athinës, duket se me këtë vendim nxiton të plotësojë ato boshllëqe të predispozitive të qeverisë së PASOK-ut për miqësi dhe bashkëpunim me vendin tone, të krijuara qysh prej vitit 1993, kur në pushtet ishte qeveria e kryeministrit Mitsotakis.

Ne fakt, tani që dimë për marrëdhëniet ndershtetërore duket se po kalon, një gjykim i ftohtë shkon në favor të mendimit se acarimi i gjatë për një periudhë

prej 20 muajsh nuk kishte ndonjë arsye thellesore, në veçanti për t'u zgatur kaq shumë dhe me kaq përplasje. Ky është kuptimi që i është dhënë shprehjes së ministrit

"humbur" dhe pasojat e saj: "boshllëqet". Vete lideri i PDSH e konfirmon këtë pohim të Papuliasit kur thotë se shpesh qeveria jone ka rënë viktime e veprimtarisë së qarqeve të caktuara shoviniste greke. E theksojmë këtë sepse do të ishte fatmirësi për të ardhmen e marrëdhënieve midis dy vendeve nëse qeveria jone ka ngaterruar qarqet e caktuara shoviniste me qeveritë në Greqi [qoftë edhe si pasoje e koncepteve të gabuara për një shoqëri demokratike], apo që qeveria në Tiranë i vazhdoi zenkat për inerci të ngatërresave të periudhës së qeverisjes së partise "Demokracia e re". Për këtë arsye është me rëndësi të theksohet se për të ardhmen e këtyre marrëdhënieve me rëndësi është reflektimi rreth këtyre faktoreve të karakterit të papjekurisë politike, pas të cilëve mund të vihet re inkandeshenca e krizës ballkanike dhe faktore të politikës së brendshme shqiptare.

Megjithatë, Papulias do të vijë në Tiranë, duke premtuar të hedhë një hap jo vetëm në parim, por një hap konkret, për përmirësimin e marrëdhënieve shqiptaro-greke.

PAPULIAS NXITON DREJT TIRANES

(...vijon nga faqja 1)

konkrete që do të hidhen drejt këtyre qëllimeve. Kjo ka një domethenie. Ose ende politika jone shtetërore nuk është çiruar prej kontraksioneve të trashëguara nga periudha 20-mujore e ngritjes, ose kërkohej që duke ia lënë iniciativën politike Athinës, pra, duke e lënë atë në pozitën e kërkuarit të fjalës, indirekt të fajesoje atë për të shkuarën. Nuk dihet, në këtë kuader, cili ishte nenteksti i vizitës së zotit Arbnori në Konispol dhe paraqitja në një formulim krejt të ri e qeshtjes game përmes gojës së tij. Mos valle ky është një mesazh se pikërisht nga kjo qeshtje duhet të fil-

lojnë bisedimet me Greqinë?

Ndërsa hamendjet mund të vazhdojnë, ministri grek Papulias i ka përgatitur valixhet për në Tiranë dhe të martën nisën e tij e miqëpelqeu edhe Papandreu. Në këtë valixhe ka shumë shprehje që të gjendet edhe propozimi për legalizimin e qendrimit të emigrantëve deri sot klandestine të Shqipërisë në Greqi, një propozim që nuk dihet pse nga zyrtarët tane u kthye mbrapsht një vit më parë, në marsin e vitit 1994, pa u lexuar fare. Tiranë, me sa duket, duhet të mendojë për protokollin, sepse nesër mund të thohet se ministri grek e vizitoi Tiranën me iniciativën e vet.

Nga Panajot Barka

Për marrëdhëniet shqiptaro-greke nuk mjafton vetëm klima pozitive

23.05.1995

Për marrëdhëniet shqiptaro-greke nuk mjafton vetëm klima pozitive

*-E pakuftueshme për Athinën nevoja e vizave shqiptare për qytetarët grekë-
-Statusi i emigrantit për shqiptarët në Greqi, realitet apo propagandë-*

**23.05. 1995
Java, fq.5**

Përmirësimi spektakolar i marrëdhënieve shqiptaro-greke në nivel diplomatik e politik krijoi vërtet premisa për zgjidhjen dhe të atyre problemeve që ekzistojnë midis dy vendeve për një normalizim të këtyre marrëdhënieve në një afatgjatësi të papërcaktuar ose më saktë për realizimin praktik të objektivit të përcaktuar nga Berisha: -nenshkrimin e një traktati miqësie e bashkëpunimi.

Ky proces normalizimi ka edhe një shans tjetër, faktin që opozitat respektive nuk kundërshtuan politikën e ndjekur nga Tirana dhe Athina zyrtare, por që kuptohet, ato nuk do të heshtin ne qoftë se të dy qeveritë nuk do të arrijnë të hedhin hapa konkrete për të dalë nga momenti i përfundimit të dimrit ndërshtetëror e që përkon me vizitën e Papulias në Tiranë në mars të këtij viti.

E ndersa presidenti Berisha i startoi këto marrëdhënie në planin diplomatik, me ftesën e përsëritur ndaj homologut

grek Stefanopulos për të vizituar Shqipërinë, ftesë e pranuar nga homologu grek në planin e zgjidhjeve praktike te problemeve, disa nga nënkomisionet e komisionit të përbashkët rifillun këto ditë aktivitetet në kryeqytetet respektive. Nga ana tjetër njësitë ushtarake shqiptare që do të marin pjesë në stërvitjen e përbashkët të disa vendeve ballkanike dhe të SH.B.A. në kuadrin e partneritetit për paqe u nisën për në Greqi të përcjella madje nga atasheju ushtarak grek në Tiranë. Këta janë treguesit e ruajtjes së klimes pozitive të vendosur. në një kohë që priten rezultate konkrete në shumë fusha të bashkëpunimit dypalësh.

Sipas vëzhguesve politikë, sa u takon takimeve të nënkomisioneve, pritet që vetëm ai i çështjeve juridike e konsullore te avancojë. Shpresohet që edhe ai i punës të arrijë rezultat por vetëm në parim. Problemet për të cilat u fol kaq gjatë dhe pati mjegullnajë do të ngelen sërish në rresht apelimi, ose do të krijoi hapësirë të re kohe

për propagandë të stilit paraelektoral. Keshtu çështja e punësimit sezonal aq e pranueshme nga të dy palët ndesh vështirësi praktike siç janë; mënyra e organizimit nga njëra anë, dhe mbrojtja e kufirit nga ana tjetër prej palës sonë. Gjithashtu nuk mund të flitet për punëtorë sezonalë pa u zgjidhur problemi i refugjatëve në Greqi.

Tanët në dosjen bisedimore më shumë pika i kanë lënë çështjes së refugjatëve shqiptarë mirëpo "bathët" tregojnë se problemi më shumë se zgjidhet do tu nënshtrohet edhe në të ardhmen instrumenteve propagantistike për dobi politike. Kjo dobi mes dy paleve më me interes mbetet për interesin tonë. Greqia përvcaiktoi numrin e emigrantëve që mund të legalizojë. Shifra shkon deri në një të tretën e numrit të përgjithshëm të tyre. E kjo do të thotë që n.q.s legalizohet 80 - 100.000 shqipëtarë, pjesa tjetër duhet të braktisin vendet disaveçare të punës dhe të jetesës, pasi ata mbetin definitivisht te palijqshëm.

Një masë e tillë është e natyrshme që nuk i pëlqen kryeqytetit tone zyrtar, i cili shikon tek emigrantët jo vetëm zbutjen e vështirësive ekonomike po edhe të ekeseve sociale. Njëherësh kjo masë është disfavorizues për vetë emigrantët të cilët rikthimin në shqipëri e vlerësojnë si një fatalitet të çastit. Nga ana tjetër ky kthim masiv në mënyrë të vetme nuk ju leverdis as pronarëve dhe punedhënësve grekë. Arsyja e kësaj modsleverdie është e kuptueshme.

Pra, statusi realë duket se është i kënaqshëm për të gjitha palët por për bën një faktor potencial për të ndikuar pozitivisht ose negativisht ecurinë e marrëdhënieve dypalëshe në të ardhmen. Në politikën e vet me Greqinë, sidomos në periudhat e zënkave mes palëve zyrtare kushti i së cilës ka pasë qënë kondicioner për zgjidhjet. Pala jonë zyrtare e lidhte legalizimin e emigrantëve me të drejtat e minoriteti grek në Shqipëri. Një paralelizëm i tillë nga Athina është konsideruar jo vetëm si arbi-

trarizëm por edhe si provokim. Pikërisht kjo e kaluar i bën vëzhguesit politikë të rishikojnë me mëdyshe edhe rezultatet e nenkomisionit për arsimin që do të mblihdet në fillim të muajit tjetër. Këtu spikat lëvizja tjetër e palës sonë zyrtare e iniciuar prej presidentit Berisha. Behet fjalë për përpjekjen që bën Tirana për shtrirjen e mësimin të gjuhës greke në shkollat e mesme. Përfaqësuesit e minoritetit grek madje edhe qarqet politike e përshtëndesin këtë hap të qeverisë shqiptare, por është i njohur fakti që ata nuk do të bëjnë lëshime në çështjen e shtatë shkollave të mbyllura vitin e kaluar të hapura në 91-shin.

Nga një analizë e tillë e fakteve vihet re se niveli i deklaruar i marrëdhënieve ose më saktë përpjekja e presidentit Berisha për tu dhënë këtyre marrëdhënieve një nivel tejet të avancuara duket se nuk bashkeudhëton me zgjidhjen e problemeve reale të gjendshme mes dy palëve.

Komentet prej dy vendeve i cilësojnë përpjek-

jet e president Berishës si të imponuara nga situata të disfavorshme ne vend për të dhe partinë e tij. Vëzhguesit politikë grek theksojnë se presidenti Berisha nuk i bashkon deklaratat me hapat konkrete. Për këtë i referojnë faktit se president Berisha fill pas vendosjes së dialogut me Athinën duhet të abrogonte dekretin sipas të cilit qytetarët grek, ndryshe nga qytetarët e tjerë të Europës se bashkuar duhet të paisen me viza për të hyrë në Shqipëri. Ky sakrilegi i vë investitorët grekë në një provë të vështirë. Për këtë arsye këta të fundit i drejtohen me presion Papuliasit për të qënë më ekzigjent me Tiranën dhe të mos shfrytëzohet hapja e Athinës për krebilitet politik nga president Berisha në Shqipëri.

Përfundimisht do të nënvizonim se klima pozitive e instaluar kohet e fundit midis dy vendeve ka nevojë për mbështetje me masa dhe vendime konkrete si dhe me procedura konstruktive për të aritur nivelin e deklaruar politik nga palët përfaqësuese të dy shteteve. /Panajot Barka

Nga Panajopt Barka
Nano më pranë Berishës
13.07.1995

Nano më pranë Berishës

Pas përshëndetjes drejtuar Kongresit të Eurocialistëve

Përshëndetja nga burgu i Bëncës i kryetarit të PS drejtuar Presidentit të Republikës zotit Sali Berishës u komentua si një deheroizëm i zotit Nano në përpjekje për t'u shpetuar hekurave të burgut dhe për t'u venë edhe de jure në krye të PS, në këtë prag zgjedhjesh parlamentare në vend. Që në krye do të thoshnim se ky arsyetim është i pasaktë dhe nuk mbeshetet tek arsyeja politike por tek sentimentet meskine të luftës politike në Shqipëri. Aq me keq është për një arsyetim të tillë "deheroik" kur lirimi i Nanos mund të lidhet me lirimin e Alisë dhe me dualitetin e mundshëm politik brenda të njëjtës forcë politike.

Është e vertet se lirimi i Nanos tani është i afert. Për këtë mund të merret si tregues edhe lirimi i Alisë. Pra, pas hyrjes së Shqipërisë në

Keshillin e Evropës, duhen deshmi konkrete të pavarësisë së gjykatave nga pushteti politik në Shqipëri. Rasti i Alisë është një i tillë. Por, ta zemë se pushteti politik, i identifikuar shpesh dhe më të drejtë me presidentin Berisha, e bëri këtë hap me Alinë, si të "parrezikshëm" për pushtetin aktual, me qellim që t'ia mohojë Nanos.

Kjo gjë mund të ndodhë me Nanon deri në rigjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, por jo në Kasacion. Brozi, veç arsyeve politike (që lidhen me konsolidimin e pavarësisë së institucionit që përfaqëson), tani, me pushimin e çështjes ndaj 12 personave zyrtarë italianë nga prokuroria e Romës, që hetoheshin për të njejtën çështje, ka arsye të plota edhe juridike për ta liruar Nanon. (Kuptohet që Brozi ndoshta e pret ndomjë rast të tillë edhe për të shlyer ndonjë

"mekatë" të së kaluarës).

Atëherë lind pyetja, pse Nano ndërmoi një hap të tillë?

Lë të mos harrojmë së F. Nano konsiderohet në Perendim si një politikan i formuar dhe i reformuar, dhe nga ana tjetër pritet që PS-ja të vijë në pushtet. Perendimi në këtë kalim pushteti shpreh dyshim se mos hakmarrja politike në Shqipëri instalohet në një rreth vicioz me rreziqe serioze për të ardhmën e politikës pluraliste shqiptare. Në një kuadër të tillë, arsyeja ta do që F. Nano me këtë deklaratë tregon se, pavarësisht nga vuajtjet personale, është në gjendje të ngrihet mbi paragjykimet dhe konceptet e një shoqërie e cila, edhe politikën e ndërton mbi principet e hakmarrjes. Dhe kjo, kuptohet përbën domosdoshmeri për çdo forcë politike në vend.

P.Barka.

Nga Panajot Barka

PD-ja do t'i japë natyrë tjetër hartës politike

16.07.1995

E diel, 16 Korrik 1995

JAVA

Faqe 7

Opinion

Opinion

Opinion

Opinion

PD-ja do t'i japë natyrë tjetër hartës politike

Atributet e të gjithëve tashmë i administrojnë partia e pushtetit.
Situata e ka ngritur moralin e udhëheqësve demokratë deri në organizime "fiestash".

Pavarësisht se periudha e pasreferendumit duket tepër e largët dhe disi e harruar, lëvizjet dhe taktikat e forcave politike si dhe e organizmave që

përfaqësojnë institucionet demokratike ndëkombëtare, madje dhe të sh-

teteve të veçanë me interesa për Shqipërinë, (në lidhje me zgjedhjet e ardhshme parlamentare), bëhen mbi rezultatet e referendimit të 6 Nentorit të vitit të kaluar.

Është e vërtetë se pas gjendjes së amullisë politike të shkaktuar

nga rezultati i këtij referendumi; ku opozita s'dinte ç'të bënte me fitoren dhe pozita me humbjen; tashmë duket se gjithçka është stabilizuar. Përgatitjet për zgjedhje po fashitin çdo lloj inkoherence në gjirin e këtyre grupimeve, ku secili zgjedh dhe vë në gjatë, deri në zgjedhje, të bind se nuk do të jetë më kjo arma efektive për PD-në.

Nga ana e vet PS-ja duket më e sigurt në fitore. Pavarësisht se nuk e deklaroi, sjelljet dhe fenomenet brenda në parti janë shprehje konkrete se PS-ja jeton që tani entuziazmin e të qenit në pushtet. Tek siguria në fitore së pari, dhe tek interesi që zgjedhjet të shtyhen matanë dimrit, së dyti, duhen kërkuar edhe lëshimet që kohët e fundit PS-ja i bën partisë në pushtet.

Nga ana tjetër edhe PS-ja duket se e vlerëson shumë faktorin e jashtëm si përcaktues në rezultatit të zgjedhjeve. Fakti që nuk reagoi ndaj lëshimeve të Berishës për instalimin në vend të aeroplanëve spiunë amerikanë, (ashtu siç veproi një vit më parë me dy aeroplanët e tjerë), lëshime që në një farë mënyre e fajësojnë Shqipërinë në konfliktin e ish Jugosllavisë, është tregues real që edhe PS-ja nuk do t'ua prishë "qejfin" të fuqishmëve që veprojnë në rajon.

Por nevoja më e madhe e PS-së është tani lirimi i Nanos. Të gjitha

gadishmeri e eficientë arsenalin e vet paraelektoral. Në këtë kuadër opozita, që për 36 e ca muaj, kërkonte zgjedhje të parakohshme, inisiativën, deri në përfundim të dimrit që vjen, ia la PD-së në pushtet.

vijon në fq. 7

të dhënat, juridike e politike, tregojnë se asgjë nuk mund ta mbajë më Nanon në Bëncë. Ata që e futën dhe e mbajnë akoma në burg, tani kuptohet që llogarisin se cili është momenti më i favorshëm për ta liruar atë. Dhe ky moment është i leverdisshëm në stinën e verës, (në kohë të tillë ai u arrestua) se pikërisht në kohë të tillë aktiviteti politik bie në minimum ashtu siç bie dhe interesi i opinionit publik. Kjo do të thotë se jehona për lirimin e tij do të jetë fare e vogël. Po ashtu lirimi i tij tani, d.m.th. në një distancë kohore relativisht të gjatë nga momenti i zgjedhjeve, minimizon efektin që mund të shkakton tek zgjedhësit lirimi i tij në prag të tyre.

Së fundi do të thoshim se hartës së forcave politike mund t'i japë një natyrë tjetër vetë PD-ja. Ajo ka në dorë ligjin elektoral i cili do të përcaktojë në një masë të madhe sidomos qëndrimin e partive të vogla përballë elektoratit, dhe detyrë të parlamentit.

P. Barka

-Iniciativën deri në fund të dimrit që vjen e ka PD-ja-

-Integrim për t'u kontrolluar

-PS-ja s'do t'ua prishë qejfin të fuqishmëve që veprojnë në rajon-

vijon nga fq. 3

Nga ana tjetër, rezultati i referendumit konfirmoi se proceset e ndodhura në vendet e tjera të Lindjes, pas rëzimit të sistemit komunist, janë të pashmangshme edhe për Shqipërinë. E nëse gjithçka duket e qartë, përse i përket vendimit të elektoratit për mënyrën e votimit, sa më shumë afrohen zgjedhjet aq më shumë forcat politike bëhen pragmatiste me synim kryesor ndryshimin e këtij vendimi në favor të vet, ku rolin kryesor pritet ta luajnë dy partitë më të mëdha në vend.

Në këtë aspekt, PD-ja në këtë prag zgjedhës, i drejtohet elektoratit shqiptar jo me kredibilitetin e politikës së

ndjekur në këto katër vjet, për qetësi publike, kush të jetese e punë, por me kredibilitetin e sukseseve të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, veçanërisht kohët e fundit. Pa mohuar meritat e PD-së në pushtet, duhet pohuar se kjo parti, në këtë përpjekje, i atribuon vetes edhe ato suksese që u përkasin të gjitha forcave politike e popullit në përgjithësi. Rasti konkret shfaqet tek anëtarësimi i Shqipërisë në KE. Megjithatë nga opozita PD-ja është akuzuar se me politikën e saj pengoi hyrjen e Shqipërisë në KE. Por vetë PD-ja e quan sukses të vetin këtë anëtarësim. Po kështu anëtarësimin në EDU e PD-së është akuzuar se

gjithë shqiptarët, në një kohë që përbën sukses vetëm për të. Një situatë e tillë, duket se ka ngritur moralin e rënë të udhëheqësve demokratë, deri në organizimin e "fiestave". Një analizë më e gjerë, duket se e sqaron situatën, pse pikërisht në këto momente i jepet përkrahje Shqipërisë dhe në mënyrë indirekte apo direkte dhe vetë PD-së nga strukturat Evropiane. Kjo është një përkrahje që po i jepet presidentit Berisha, me qëllim që në zgjedhjet e ardhshme të arrijë më së shumti në kufijt e një opozite të fortë. Qëllimi është që të mënjanohet pushteti absolut i të majtëve, dhe brenda Parlamentit të

ketë një opozitë e fortë, që presupozon heqjen e mundësisë së krijimit të situatave politike të ngjashme me ato të mandatit të PD-së. Po ashtu integrimi i Shqipërisë në strukturat Evropiane shërben si një kontroll garancie për avancimin në rrugë të drejtë të proceseve demokratike në Shqipëri. Vetë presidenti Berisha dhe PD-ja, duket se janë plotësisht të bindur për këtë. Madje për arrijtjen e një objekti të tillë, ndoshta do të detyrohen të pranojnë kualicionin me të gjithë anëtarët e familjes së djathtë të shkëputur apo jo prej saj. Fakti që "suksesi" diplomatike të politikës së jashtme të partisë në pushtet nuk mund të vazhdojnë me të njëjtin intensitet dhe përgjithësi

Opinionone

Opinionone

Opinionone

Tranzicioni dhe vlerat në udhëkryq

Tranzicioni dhe vlerat në udhëkryq

Zëvendësimi i sistemeve shoqërore dhe periudhat e tranzicionit, përbëjnë fenomene të njohura si nga pikëpamja historike, ashtu dhe përsa u përket ndikimeve të tyre në ristrukturimin e vlerave të përgjithshme të një shoqërie. Konstatimi i përgjithshëm mbetet ai që në këtë kalim kompleks me sens përgjithësisht progresist, momenti më delikat por dhe më deciziv, është ai i krijimit të vlerave të reja, morale, kulturore dhe shoqërore nga anëtarët e një shoqërie të caktuar.

Për këtë proces, ekzistojnë dy koncepte:

I pari, konsiderohet amerikan.

Sipas këtij koncepti, pak a shumë vlera të reja konsiderohen mjaft gjëra që i përkasin kësaj sferë që tërheq sa më shumë njerëz, për efekte konsumi. Ky koncept, mbështetet tek multigjeneza e amerikanëve dhe tek egzistenca e institucioneve përkatëse, të afta për të thithur dhe për të përpunuar çdo vlerë të vjetër a të re, e ardhur nga çdo skaj i rruzullit tokësor apo dhe nga individë të caktuar. Në bazë të këtij koncepti vlerat e huazuara marrin vulën amerikane duke siguruar mbartësit e konsideruar konsumatorë.

Koncepti i dytë mbetet ai Evropian

Vlerat e reja të një shoqërie të caktuar konsiderohen të tilla, pra dhe të qën-

drueshme, të qenësishme dhe funksionale, kur përbëjnë një vijimësi të traditës qindrvjeçare të gërshetuar me traditën më të afërme.

Për vendin tonë në këtë fazë tranzicioni, procesi i krijimit të këtyre vlerave duket se ka mbetur në një udhëkryq. Kjo, jo vetëm për faktin se këto procese i janë lënë spontanitetit, por dhe trashëgimia e sistemit të sapo përmbytur nuk mund të jetë, në aspektin ekonomik-shoqëror, shtyratë iniciues në funksion të një shoqërie të re. Nga ana tjetër, vetë shteti i ri tregon mangësi të theksuara në aspektin e krijimit të institucioneve përkatëse që mund të stimulojnë, e pse jo të orientojnë, pikërisht krijimin e vlerave të reja. Në Shqipëri në këtë moment duket se jemi në fazën e rënimit.

Nevoja për mbijetesë, kërkesa për fitim maksimal, ka prekur rëndë konstitucionin e familjes.

Duke iu referuar realitetit dhe burimit të vetëm të informacionit të tanishëm në vend-shtypit, vëmë re se shumë vlera egzistuese janë zhvlerësuar. Ky fenomen diktohet nga dy faktorë që karakterizojnë jetën shqiptare sot dhe që përcaktojnë dhe shtresimet e reja kryesore të shoqërisë. Këto janë nevoja për të mbijetuar dhe

kërkesa për fitim maksimal. Pikërisht këta dy faktorë të aspektit të thellë ekonomik, kanë çenuar në një masë të madhe konstitucionin e familjes shqiptare. Pikërisht, liberalizimi i jetës solli një shpërthim të tradhëtisë bashkëshortore e si pasojë, shtimin deri në masën 30-40% të divorceve të çifteve të rinj, ku paditëset kryesore janë gratë. Pasojë e këtij fenomeni, është dhe krimi brenda në familje aq i shpeshtë kohët e fundit. Gjithashtu nuk janë të pakta rastet, kur me mirëkuptim bashkëshortor, shtyrë nga nevoja për të jetuar, aplikohet shitja e mishit të bashkëshortes. Tregëtia e femrave, në emër të mbijetesës dhe fitimit, është një fenomen tronditës për shoqërinë tonë në tranzicion. Akoma më tronditëse është shitja e fëmijëve të grabitur. Tragjizmi i këtij fenomeni arrin kulmin kur kjo shitje realizohet me pëlqimin e

prindërve të tyre.

Vlerat kulturore konvertohen në para

Duke e keqinterpretuar idenë e shoqërisë së tregut, vihet re një konvertim i vlerave kulturore materiale të krijuara për shumë breza, në para. Ato u shitën fillimisht nga

keqbërës ordinerë ndërsa sot nga trafikantë profesionistë. Grabitja e muzeve, gërmimet në vende të njohura arkeologjike dhe rëmbimi i antikuarëve, deri dhe nga nënuji, flasin qart për një varfërim e zvetënim të bazës egzistuese kulturore. Ky fenomen, të cilin do ta karakterizojmë: "fenomeni i piedestaleve boshe", nuk është i dhimbshëm vetëm se varfëron një kulturë materiale, por se dëmton edhe një perspektivë zhvillimi të vendit-turizmin.

I dhimbshëm është, p.sh për Gjirokastrën, udhëtimi i rozetave, i tavanëve dhe i gdhendjeve të tjera ornamentale të shtëpive gjirokastrite, kryesisht drejt Greqisë. Një udhëtim i tillë, bashkë me zbrazen e muzeve dhe institucioneve kulturore, dhe betonizimin e arqitekturës gurorë tradicionale, mbetet vrasës edhe për perspektivën turistike të Gjirokastrës.

Muzika e re e hedhur për "konsum" abandonon traditën

Fakt është që kënga popullore tradicionale, madje edhe ato doke dhe zakone që lidhen me momente kryesore të ciklit të

suritë folklorike, akoma dhe kënga polifonike, dalngadalë po bëhen pronë e grupeve të veçanta, të cilët për të mbijetuar duhet ta mbartin me qëllim shitjen. Në këtë aspekt, problemi përsëri është i dyfishtë. Pra, jo vetëm që folklori ndrydhet, por duket se po fiton tendencën e abandonimit të tij në procesin e krijimit të muzikës së re shqiptare. Një vështrim spontan të bind se muzika që sot dëgjohet dhe prodhohet, është ose huazim, ose imitim. Pra tradita e re muzikore nuk ka si nënshtraz trashëgimnie muzikën popullore, siç ndodhi me traditën e re muzikore në Greqi, në Spanjë, në Itali e gjatë, apo dhe me muzikën "pop", por më së shumti, në imitime të

grupeve muzikore të huaja. Eli Fara që konsiderohet si një nga këngëtarët e pakta që bën përpjekje për të çarë në një rrugë të tillë e pranon me dhimbje këtë realitet kur thotë se dhjetra grupe të rinjsh me këngët e tyre ritmike e imitime të huaja zhvlerësojnë përditë e më shumë përpjekjen tonë por dhe origjinalitetin e muzikës tonë të re.

Panajot Barka.

Opinion

Opinion

Opinio

Tranzicioni dhe feja

Nga cikli i shkrimeve "Tranzicioni dhe vlerat në udhëkryq"

Feja përbën institucionin primar shpirtëror për njeriun dhe për fisnikërimin e tij. Që këtej buron dhe funksioni sublim i fesë në shërbim të shoqërisë dhe përparimit të saj. Si e tillë, feja është njëkohësisht një institucion me peshë të jashtëzakonshme në mjedhën historike të një shoqërie të caktuar apo dhe të mbarë njerëzimit në tërësi. Në shumë vende, në momente të caktuara historike apo dhe në vijimësi feja, ka rol të konsiderueshëm në proceset politike, shtetformuese apo dhe kombëformuese. Revolucioni kombëtar grek i 1821-it, psh, kishte si pikënisje dhe mbështetje të fuqishme kishën dhe njerëzit e kishës. Për shumë vende si Polonia, Rusia, Spanja, apo Serbia etj, feja përbën një komponent shumë të rëndësishëm në përmbajtjen e konceptit shtet apo komb.

Pak a shumë i ndryshëm është roli i fesë në vendin tonë. Konfiguracioni i ndryshëm fetar i deturoi udhëheqësit politikë shqiptarë, që në momentet decizive për hir të...

Patriotizmit dhe të nevojave kombëtare të ngriheshin mbi fetë, dhe

... ato të kalonin në dorë të dytë. Thirrja e Pashko Vasës, "Feja e Shqiptarit është shqiptaria", apo dhe shumë rilindasve të tjerë, parrulla e Konferencës së Pezës, për t'u ngritur në luftë kundër fashizmit pa dallim feje, apo akoma dhe deviza e tanishme e udhëheqësit të njerit prej besimeve më të mëdhenj në vend, se uniteti kombëtar është më i rëndësishëm se ai fetar, vë në pah pikërisht atë, se fetë e ndryshme në Shqipëri në momente kthesash historike për vendin, shiko-heshin nga udhëheqësit politikë, si pengesë e mundshme për realizimin e kësaj kthese. Nga ana tjetër, njerëzit e thjeshtë, mbartës të këtyre besimeve, në jetën normale, pra nuk bëhet fjalë për momente

kritike, kurrë nuk i kanë vënë re dallimet fetare midis tyre. Kjo tregon në njëfarë mënyre se ata nuk ishin besimtarë fanatikë, në kuptimin e mirë apo të keq të fjalës, ose, siç thekson dhe Kadareja, kishin gjithmonë të pranishme origjinën e tyre të përbashkët fetare.

Tranzicioni-feja dhe roli i saj

E vërteta është se mohimi i fesë dhe zëvendësimi i saj me ideologjinë komuniste nga rregjimi i kaluar, përbente një nga shkeljet më makabre të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Kjo solli si pasojë që periudha e porsa rehabilitimit të fesë, pra periudha e tranzicionit që përshkoi, të trashëgonte dy breza njerëzish pa kulturë, fetare dhe një vakum të plotë udhëheqësish shpirtëror fetarë dhe infrastrukturë për të. Madje dhe besimtarët e vërtetë, qenë të paktë. Megjithatë, institucionet fetare qoftë dhe të paktë në numër dhe gjysmë të rënur, ndjenë peshën e madhe të njerëzve. Më shumë se besimi ata i çoi atje edhe yshtja e brendshme për të fituar ndjenjën e besimit ndaj zotit. Fenomen interesant në këtë periudhë mbetet preferenca e besimit. Njerëzit në Shqipëri thirrën në fillim në ndihmë origjinën familjare për të zgjedhur besimin. Pak kohë më vonë kjo tabu u thye dhe njerëzit filluan të bëhen besimtarë të atij besimi që i përshpatej më mirë, me tendencë kryesore kërkimin e origjinës së hershme fetare pa e kthyer këtë proces kurrë në modë. Kjo bëri që nga e njëjta familje një pjesë e anëtarëve të shkojnë në xhami e një pjesë tjetër, (veçanërisht të rinjtë) të shkojnë në kisha. Një fenomen i tillë çoi në atë që shifrat që u përkisnin përqindjes së katër religjioneve fetare në Shqipëri, (myslimanë, bektashianë, ortodoksë dhe

katolikë) në një periudhë më të hershme, të mos i korrespondojnë realitetit. Për periudhën e tanishme është e vlefshme formula se në Shqipëri ekzistojnë besimtarët e religjioneve të njohura tradicionalisht dhe përballë tyre qëndron një numër i madh njerëzish të cilët ende nuk kanë vendosur, ose vendosin dita-ditës. Pavarësisht nga këto, feja ose fetë tek ne mbeten përsëri jashtë zhvillimeve të tjera në vend dhe njerëzit më shumë janë të angazhuar në luftën për mbijetesë ose mbifitim. Por shpesh, në momente ngecjeje apo pa rrugëdalje, ishte politika ajo që kishte punë me fetë apo me religjione të veçanta.

Shteti laik dhe religjionet fetare

Shteti i ri demokratik ndërsa siguroi në parim liritë fetare dhe shpalli mëvetësinë e vet nga feja, në praktikë, duke mos krijuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe duke mos shfaqur barazi qëndrimesi ndaj të gjitha religjioneve fetare, shteti luajti dhe vazhdon të luajë rolin e një arbitri të keq karshi tyre. Kjo pabarazi qëndrimesh e shtetit ndaj religjioneve fetare tradicionale vihet re sidomos në çështje të rikthimit të pronave të religjioneve, sidomos për katolikët dhe ortodoksët dhe të lejimi i misionarëve të huaj fetarë për të ndihmuar religjione të veçanta, ku religjione të tilla si ai ortodoks, denigrohen. Të gjitha këto çuan, në momente të caktuara, në reagime qoftë edhe të pa shprehura qartë, të besimtarëve ndaj veprimeve të pushtetit politik. Kuptohet që këto reagime duke u veshur shpesh me petk politik, apo me rritjen e ndërgjejes fetare të besimtarëve mund të thellohet, të çojnë në fanatizëm, apo dhe në fontamentalizëm dhe pasojat më tej bëhen të pakontrolluara. Religjionet fe-

tare dhe bashkëjetesa e tyre pikërisht në këto momente të vështira tranzitive që kalon vendi po shfaqet dhe rishfaqet përherë e më shumë problemi i unitetit ndër fetar. Kjo diktohet me sa duket dhe nga klima e tensionuar në Ballkan ku papajtueshmëria ndër fetare ndezi shkallën më të lartë të konfliktit, luftën. Në Shqipëri përzierja fetare e popullsisë, sidomos nëpërmjet martesave në kohën e ateizmit, por që vazhdon ende, duket se thelton premisat e lavdërueshme për bashkëekzistencë fetare. Por kjo krijon dhe rrezikuese në rast se kjo bashkëjetesë çënohet në një farë mënyre, atëherë përfundimet do të jenë tepër të dhimbshme. Megjithatë I. Kadare paralajmëron në një intervistë të kohëve të fundit, për tendencën ecentrike të katolicizmit, ndërkohë që fton në skenë bektashizmin, i cili, sipas tij, jo vetëm përbën 50% të mysli-

manëve shqiptarë, por edhe sektin më tolerant ndër religjionet fetare në Shqipëri. Por frika e ç'ekuilibrave fetare lidhet mesa duket me vërshimin e dhjetra sekteve fetare dhe qindra misionarëve të tyre nga e gjithë bota të cilët pretendojnë shpirtin e shqiptarit. Problemi nuk shtrohet thjesht në aspektin se këto sekte ngushtojnë sferën e "influencës" e katër religjioneve tradicionale, por të ciptimi gjithnjë e më i madh i konfiguracionit fetar në vend, që edhe kështu duket i vështirë. Këtu nuk duhet të harrojmë gjithashtu faktin se shumë nga këto sekte apo organizma fetare që veprojnë në Shqipëri, vetëm petkun kanë fetar. Adresa e tyre, po të gërmosh më thellë nuk të çon te zoti. Kështu që apriori mund të pranojmë tezën se nën petkun e fesë e të humanizmit fetar është gjetur mënyra më e mirë për organizimin e funksionimin e shërbimeve nga më të ndryshmet. Por kjo i ngjan shpesh kurdisjes së një mine me sahat.

Panajot Barka